

Vendim nr. 35 datë 22.11.2022

(V-35/22)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Altin Binaj, Sandër Beci, Ilir Toska, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datën 15.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 1 (U) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **UNIONI I GJYQTARËVE TË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga Gerd Hoxha dhe Genti Dokollari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga Mimoza Arbi dhe Erind Mërkuri.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar me autorizim nga Herald Jonuzaj dhe avokatja e shtetit Irma Qosja.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, përfaqësuar me autorizim nga Qemal Zaimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166/2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 15, 17, 18, 116, 124, 125, 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “h”, 138 dhe 145 të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGG*), i cili u shpreh vetëm për pranimin e kërimit të parë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi në vitin 2016 miratoi ndryshimet kushtetuese të lidhura me reformën në drejtësi, me synimin për të siguruar integritetin, llogaridhënien dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë për qytetarët, në përputhje me standardet më të mira evropiane. Pjesë e paketës ligjore është edhe ligji nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 96/2016*), i cili ka për objekt përcaktimin e statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me të drejtat e detyrimit e tyre, pranimin dhe emërimin, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, si edhe përgjegjësinë disiplinore, penale e civile. Në Pjesën II të këtij ligji rregullohen të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, ndërsa në Kreun III të saj (nenet 11-22) rregullohen paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore.

2. Neni 11, pika 1, i ligjit nr. 96/2016, parashikon se paga e magjistratit duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e detyrës së tij dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit. Në pikën 2 të këtij neni janë renditur këto kritere mbi bazën e të cilave caktohet paga e magjistratit: a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin; b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit; c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin; ç) pozicioni drejtues.

3. Paga e magjistratit caktohet sipas parashikimeve të nenit 12, i cili në pikën 5 përcakton elementet përbërëse të pagës mujore bruto, ku renditen: a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me “pagën për funksion” të

punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave; b) shtesa për pagën në grup, e cila është shuma që rezulton nga shumëzimi i pagës referuese bazë me koeficientin në përqindje, sipas funksionit që magjistrati ushtron, referuar pikës 2 të këtij neni, përkatësisht: i) G1 90 për qind; ii) G2 98 për qind; iii) G3 106 për qind; c) shtesa për vjetërsi, e llogaritur mbi pagën referuese bazë, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni; ç) shtesa për pozicionin drejtues, e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji; d) shtesa për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

4. Ligji nr. 96/2016, në nenin 169, që është dispozitë kalimtare, përcaktoi se Pjesa II, Kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe përfitimet e tjera është e zbatueshme për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por në asnjë rast jo më shpejt se data 01.01.2019. Përfundim nga ky rregull bëjnë magjistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera sipas këtij ligji, me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera (pika 5). Gjithashtu, në këtë dispozitë përcaktohej edhe se magjistrati që ka kaluar procesin e rivlerësimit pas datës 01.01.2019, gëzon të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pagës e përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji, brenda tre muajve nga vendimi i formës së prerë të rivlerësimit (pika 6).

5. Pas miratimit të ligjit, neni 169 i tij, është bërë objekt i kontrollit kushtetues mbi kërkesën e dy shoqatave të gjyqtarëve. Me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, Gjykata Kushtetuese (Gjykata), ndër të tjera, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 5, fjalia e fundit, dhe pikës 6, të këtij neni, duke arsyetuar se *“ligjvënësi e ka kushtëzuar zbatimin e skemës së re të trajtimit financiar të magjistratëve me dy kritere, që përfshijnë kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit dhe plotësimin e një afati kohor i cili shtrihet deri në 1 janar 2019. Gjykata konstaton se deri në datën 1 janar 2019 magjistratët do të vijojnë të përfitojnë pagë dhe përfitime të tjera në përputhje me parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse pas datës 1 janar 2019 trajtimi financiar i tyre varet nga kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit, çka nënkupton se ata*

magjistratë që e kanë kaluar me sukses këtë proces gëzojnë të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera para hyrjes në fuqi të ligjit me ato sipas këtij ligji, kurse për ata që ende nuk e kanë përfunduar atë proces, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera (pika 5 e nenit 169). Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se rregullimi ligjor i fjalisë së fundit të pikës 5 të nenit 196 dhe ai i pikës 6 të po këtij neni krijojnë kushtet për trajtim të pabarabartë të magjistratëve që ndodhen në kushte të njëjta, pa përlligje objektive dhe të arsyeshme. Për më tepër, Gjykata çmon se trajtimi financiar i pabarabartë i magjistratëve pas datës 1 janar 2019 nuk është mjeti i duhur për të përmbushur objektivin e ligjvënësit për të siguruar dinjitetin e profesionit dhe një pagë të përshtatshme si domosdoshmëri për të mbrojtur gjyqtarët nga ndërhyrje të jashtme të papërshtatshme.” (shih paragrafët 99-100 të vendimit nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

6. Paga e magjistratëve, sipas skemës së re të trajtimit financiar të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, ka filluar të zbatohet pas datës 01.01.2019. Në përlllogaritjen e pagës mujore të magjistratëve, elementi “pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave”, është llogaritur sipas pikës 2 të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” (VKM nr. 187/2017). Konkretisht, ky element është llogaritur me vlerën 118,100 lekë, që përkon me elementin e pagës “shtesë për pozicion”, për kategorinë II-a, në lidhjen nr. 1 të VKM-së nr. 187/2017 dhe sipas terminologjisë së përdorur në këtë vendim nënkupton këtë element të pagës të përcaktuar për pozicionet e përfshira në klasën e dytë, kategoria e parë.

7. Në muajin tetor-nëntor të vitit 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), mbi bazën e kërkesës së datës 13.10.2020 të KLGJ-së, ka kryer pranë kësaj të fundit një auditim tematik të përputhshmërisë, të ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e përlllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë, ndër të tjera, vjetërsinë në punë (për anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së), si dhe kuadrin ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet përlllogaritja. Në përfundim të këtij auditimi, me shkresën e datës 15.02.2021, KLSH-ja i ka dërguar KLGJ-së raportin

përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin tematik. Në kuadër të masave organizative, për sa i përket përllogaritjes së pagës së magistratëve, KLSH-ja ka dhënë këtë rekomandim: *“Për të gjithë magistratët, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përllogaritet mbi bazën e plotë të pagës së drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000 + 118,100) dhe jo siç përllogaritet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100). Paguesa duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ose emërimit për personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet.”.*

8. Në datën 11.03.2021 KLGJ-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për fonde buxhetore shtesë për vitin 2021, në funksion të përmbushjes së rekomandimit të KLSH-së. Ministria e Financave nuk e ka pranuar kërkesën, duke parashtruar arsyet në përgjigjen e datës 07.05.2021.

9. Në datën 23.03.2021, me nismën e një deputeti, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 50/2021). Mes të tjerash, me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021 është ndryshuar neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016, i cili tani ka këtë përmbajtje: *“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. “Shtesa për pozicion” është elementi bazë i pagës mujore të nëpunësve civilë, nëpërmjet së cilës caktohet vlera e çdo vendi pune në shërbimin civil, pa u diktuar nga ndryshimet e pagës që shkaktohen nga rrethanat e posaçme ose individuale të vetë nëpunësit civil si vjetërsia apo shtesa për kushte pune. Për qëllimet e caktimit të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, “shtesa për pozicion” është i njëjti element i pagës si edhe elementi “paga bazë e kategorisë”, sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, apo me çdo lloj emërtimi tjetër që cakton elementin bazë të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” ose “paga bazë e kategorisë” sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të*

mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 14.05.2021 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

10. Neni 11 i ligjit nr. 96/2016, që përcakton parimet e caktimit të pagës dhe përfitimeve financiare të magjistratit, në pikën 3 ka listuar në mënyrë jo shteruese përfitimet e tjera financiare të magjistratit, ndër to edhe pensioni shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare. Kurse në nenin 21 të ligjit nr. 96/2016 rregullohen posaçërisht pensioni suplementar dhe përfitimet e tjera. Kjo dispozitë i ndan magjistratët në tri kategori: i) magjistratët në përgjithësi; ii) magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë; iii) kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm. Ndarja e tyre në këtë mënyrë është bërë me qëllim klasifikimin e secilës kategori sipas grupeve përkatëse përfituese në kuptim të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

11. Sipas ligjit nr. 96/2016 magjistratët në përgjithësi përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” (*ligji nr. 8097/1996*) të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e dytë, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 9 të nenit 1 të këtij të fundit. Referuar nenit 10 të ligjit nr. 8097/1996, sipas përmbajtjes së tij në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, kushtet e përfitimit për personat e grupit të dytë janë: a) të kenë kryer 35 vjet shërbim në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose b) të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*); ose c) para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr. 7703/1993. Po kështu, personat e këtij grupi, që plotësojnë një nga këto kushte, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike. Ndërsa, sipas nenit 11 të tij, gjithnjë sipas përmbajtjes në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, masa e pensionit shtetëror suplementar për personat e grupit të dytë, sipas shkronjës “a” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji është 1,5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi.

12. Po sipas ligjit nr. 96/2016, magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji nr. 8097/1996, të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës “b” të pikës 8 të nenit 1 të këtij të fundit. Referuar nenit 8 të ligjit nr. 8097/1996, sipas përmbajtjes së tij në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, kushtet e përfitimit për personat e grupit të parë janë: “1. Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke filluar

nga data 1.1.2032, moshë e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arritjen e moshës 63 vjeç; 2. Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 8 të nenit 1; 3. Të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.”. Ndërsa sipas nenit 9 të tij, gjithnjë sipas përmbajtjes në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, masa e pensionit shtetëror suplementar për personat e grupit të parë, sipas shkronjës “b” të pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji, është 20 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në masën 0,8 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi. Kjo dispozitë, për personat e këtij grupi (grupi i parë, sipas shkronjës “b”, të pikës 8, të nenit 1, të ligjit) parashikonte, gjithashtu, se masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese, kurse masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703/1993, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.

13. Në vijim, sipas ligjit nr. 96/2016, kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji nr. 8097/1996, të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të pikës 8 të nenit 1 të tij, sipas kushteve të përmendura më lart (*shih paragrafin 12 të këtij vendimi*). Ndërsa sipas nenit 9 të tij, sipas përmbajtjes në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, masa e pensionit shtetëror suplementar për personat e grupit të parë, sipas shkronjës “a” të pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji, është 25 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar në masën 1 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi. Kjo dispozitë, për personat e këtij grupi (grupi i parë sipas shkronjës “a” të pikës 8 të nenit 1 të ligjit), parashikonte, gjithashtu, se masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se 60 për qind e pagës referuese, kurse masa e pensionit shtetëror suplementar plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703/1993 nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.

14. Lidhur me kuptimin e termit “pagë referuese”, pika 7 e nenit 1 të ligjit nr. 8097/1996, sipas përmbajtjes në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, përcaktonte se me të do të kuptohet “paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë” ndërkohë që “paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare.”.

15. Në datën 23.12.2020, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 166/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar” (ligji nr. 166/2020), i cili me nenin 1 ka ndryshuar, mes të tjerash, edhe përmbajtjen e pikës 7 të nenit 1 të ligjit nr. 8097/1996, që tani parashikon: *“Me termin “pagë referuese” kuptohet paga e muajit më të fundit, sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë. Për funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, me termin “pagë referuese” kuptohet: a) për personat, të cilët kanë vite shërbimi deri më 31.12.2018, pavarësisht datës së lindjes të së drejtës për përfitim, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion apo detyrë, sipas legjislacionit në fuqi, deri në datën 31.12.2018; b) për personat, të cilët kanë vite shërbimi pas datës 1.1.2019, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës; c) për personat, të cilët kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018, paga referuese për periudhën e shërbimit është paga mesatare mujore referuese që llogaritet si raport i shumës së pagave referuese të të gjitha funksioneve e detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, me shumën e muajve që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet e detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe e pagesës kalimtare.”.* Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 7, datë 15.01.2021 dhe ka hyrë në fuqi më 30.01.2021.

16. Me kërkesën e datës 01.07.2022, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (Unioni) i është drejtuar Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, si dhe të nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 166/2020.

17. Me vendimin e datës 26.07.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

18. Në datën 11.11.2022 është regjistruar në Gjykatë kërkesa e Unionit për shtim të objektit të kërkesës, duke përfshirë në të edhe kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të shkronjës “a” të pikës 7 të nenit 1 të ligjit nr. 8097/1996.

19. Në parashtrimet me shkrim të datës 19.10.2022 drejtuar Gjykatës, subjekti i interesuar, Kuvendi, me pretendimin se objekt kërkesë janë norma juridike që ndodhen në ligje të ndryshme e përmbajnë parashikime të ndryshme, për rrjedhojë kërkojnë trajtime të ndryshme, ka kërkuar veçimin e çështjeve dhe shqyrtimin e tyre më vete, në mënyrë që palëve në proces t'u jepet mundësia të debatojnë në mënyrë shteruese për secilin prej tyre. Kurse në datën 14.11.2022, pasi është njohur me kërkesën për shtimin e objektit të kërkesës, Kuvendi ka kërkuar shtyrjen e seancës plenare publike, me qëllim që t'i jepej kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes për argumentet e parashtruara nga kërkuuesi lidhur me shtimin e objektit, si dhe thirrjen si subjekt të interesuar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, bazuar në nenin 39, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, në kushtet kur objekti fillestar i kërkesës dhe shtesa e tij prekin elemente të buxhetit të shtetit, menaxhimit të tij e disiplinës financiare.

20. Në datën 14.11.2022, përpara seancës plenare publike, një prej anëtarëve të Gjykatës i paraqiti Kryetares kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se ka qenë anëtar i shoqatës kërkuuese dhe në momentin e paraqitjes së kërkesës ushtronte detyrën e gjyqtarit në gjykatën e apelit, pra gëzonte statusin e magjistratit që kërkon anëtarësia në këtë shoqatë, sipas statutit të saj.

21. Me vendimin nr. 22, datë 14.11.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, duke mbajtur në konsideratë se objekti i gjykimit lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve dhe në kushtet kur nuk konstatoi përfshirjen e tij në vendimmarrjen e organeve drejtuese të shoqatës për ngritjen e çështjes përpara kësaj Gjykate, vlerësoi se anëtari nuk ndodhej në asnjë prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000, si dhe mbështetur edhe në pikën 2 të po këtij neni, vendosi rrëzimin e kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

22. Në seancë plenare, subjekti i interesuar, Kuvendi, hoqi dorë si nga kërkesa për shtyrje të seancës dhe thirrjen si subjekt të interesuar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe nga kërkesa për veçimin e çështjeve.

23. Përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i interesuar, Kuvendi, bazuar në parashikimet e nenit 36, shkronjat "c" dhe "ç", të ligjit nr. 8577/2000, kërkoj përjashtimin e të njëjtit anëtar të Gjykatës, duke parashtruar si shkak se ai, sipas akteve bashkëlidhur kërkesës, rezultonte të kishte qenë anëtar themelues i shoqatës kërkuuese. Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë për të njëjtat arsye si më sipër, për të cilat vendosi edhe rrëzimin e kërkesës për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes.

24. Në lidhje me kërkesën për shtimin e objektit të kërkesës, pasi dëgjoji palët në gjykim, Gjykata vendosi pranimin e saj.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

25. **Kërkuesi, Unioni**, ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se dispozitat ligjore të kundërshtuara bien ndesh me:

25.1. *Për nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 50/2021:*

25.1.1. *Garancitë kushtetuese të statusit të gjyqtarit, të parashikuara në nenin 138 të Kushtetutës.* Pas fillimit të zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullojnë pagën e magjistratit, KLSH-ja konstatoi se referenca ishte e gabuar dhe rekomandoi rillogaritjen e pagës dhe pagesën e diferencave. KLGJ-ja nuk veproi për sa më sipër, përkundrazi u ndërmor nisma ligjvënëse për ndryshimin e bazës ligjore për pagën referuese, duke u riformuluar dispozita sipas mënyrës që ishte përlllogaritur paga deri para konstatimeve të KLSH-së. Edhe pse neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016 ishte i qartë, ai u riformulua sipas mënyrës së gabuar të zbatimit të kësaj dispozite, duke sjellë uljen e pagës së magjistratëve. Këto ndryshime nuk u diktuan dhe nuk u iniciuan për asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 138, por për të “korrigjuar” gabimin e bërë në përlllogaritjen e pagave dhe për të sanksionuar si të ligjshme e korrekte mënyrën e interpretimit të bërë deri në atë moment.

25.1.2. *Parimin e shtetit të së drejtës*, për shkak se dispozita e kundërshtuar, duke ndryshuar me efekt negativ pagën e magjistratit, nuk respekton garancitë kushtetuese që burojnë nga statusi i tij sipas nenit 138 të Kushtetutës, si dhe parimin e hierarkisë së akteve normative, sipas nenit 116 të Kushtetutës.

25.1.3. *Parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor*, sipas të cilit pavarësia e gjyqtarëve, paprekshmëria e mandatit, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensioni dhe mosha duhet të sigurohen nga legjislacioni në mënyrë të përshtatshme. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe në rast se preket ndonjëra prej tyre, administrimi i drejtësisë është i cenuar.

25.1.4. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi dispozita e kundërshtuar cenon pritshmëritë e ligjshme të magjistratëve dhe besimin e tyre të garantuar nga vetë Kushtetuta se

paga (statusi) e tyre nuk mund të cenohet përveçse në raste të parashikuara shprehimisht nga ky akt, që në këtë rast nuk ekzistojnë.

25.2. *Për nenin 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996, të ndryshuar me nenin 1, të ligjit nr. 166/2020:*

25.2.1. *Garancitë kushtetuese të parashikuara në nenin 138 të Kushtetutës dhe parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, pasi ndryshimi vetëm për magjistratët cenon të ardhurat për pensionin suplementar, për rrjedhojë mirëqenien e tyre ekonomike për kohën që dalin në pension. Dispozitat e kundërshtuara janë negative në raport me ato të nenit 21 të ligjit nr. 96/2016, pasi kanë ndryshuar kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, të cilit i referoheshin deri në datën e këtij ndryshimi. E drejta e magjistratëve që pensioni suplementar të lidhet me pagën referuese më të fundit, është një e drejtë që e kanë gëzuar prej vitesh, ndërsa dispozitat e kundërshtuara janë negative dhe alogjike, pasi referojnë në periudhën kohore ku pagat kanë qenë më të ulëta.*

25.2.2. *Parimin e sigurisë juridike, pasi cenohen të drejtat më të favorshme të fituara tashmë dhe pritshmëritë e ligjshme të magjistratëve që trajtimi i tyre, sipas nenit 21 të ligjit nr. 96/2016, të ishte i njëjtë me subjektet e tjera dhe të mos pësonte ndryshime të disfavorshme. Ligjvënësi nuk ka respektuar as parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në përcaktimin e formulës përlllogaritëse, që passjell në mënyrë të drejtpërdrejtë uljen e pagës referuese mbi të cilën përlllogaritet pensioni suplementar, për rrjedhojë uljen e këtij pensioni në masën 47-50%.*

25.2.3. *Parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi ndryshimet ligjore krijojnë një regjim ligjor të dyfishtë, të diferencuar për subjekte të njëjta. Paga referuese për të gjitha subjektet e ligjit është “paga e muajit më të fundit për atë funksion a detyrë”, ndërsa për magjistratët paga referuese ndahet në tri periudha. Referimi te paga për funksion deri më 31.12.2018, sipas shkronjës “a” ose “c” të pikës 7 të nenit 1, sjell uljen e pagës referuese për subjektet që kanë përfunduar funksionet para kësaj date, për rrjedhojë uljen e pensionit suplementar. Subjektet që kanë dalë në pension deri më 29.01.2021 janë trajtuar me pagën e muajit të fundit për funksion, për rrjedhojë kanë përfituar pension suplementar më të madh se sa ata që u lind e drejta pas kësaj date e në vijim. Ndërsa për subjektet e tjera nuk ka kufizime për sa i përket nivelit*

maksimal të përfitimit, për magjistratët është vendosur si tavan paga e Presidentit të Republikës (*Presidenti*), pavarësisht se piramida e pagave është “thyer” dhe magjistratëve u mbahen kontribute mbi një pagë bruto më të lartë. Ky parashikim vlen edhe për subjekte të tjera të shtuara me ligjin nr. 166/2020, por i takon Gjykatës të vlerësojë nëse do të zgjerojë kryesisht objektin e shqyrtimit, sipas nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

26. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka prapësuar sa më poshtë vijon:

26.1. *Për legjitimitimin e kërkuarit*

26.1.1. Në krye të kërkesës shënohet “bordi drejtues”, pra vendimmarrja për të vënë në lëvizje Gjykatën është marrë nga ky organ i shoqatës, por në materialet e përcjella nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të tij për këtë qëllim. Po kështu, bazuar në nenin 33 të statutit të shoqatës, mandati i organeve të zgjedhura me vendimin e datës 18.04.2018 ka përfunduar më 18.04.2021, pra para vënies në lëvizje të Gjykatës, dhe kërkuari nuk ka paraqitur ndonjë akt që të provojë zgjedhjen e organeve të reja të shoqatës gjatë kësaj periudhe. Me mbarimin e mandatit të organeve përfaqësuese kërkuari nuk legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate.

26.2. *Për vlerën e rekomandimeve të KLSH-së*

26.2.1. Raporti i KLSH-së, që, në thelb, ka krijuar mosmarrëveshjen kushtetuese dhe ku mbështet pretendimet kërkuari, nuk mund të merret parasysh, pasi rekomandimet e këtij organi janë këshillimore, ndaj nuk kanë qenë detyruese për KLGJ-në dhe Kuvendin. KLSH-ja nuk ka qenë konseguente, pasi një parregullsi e tillë, në lidhje me llogaritjen e pagës, nuk është konstatuar në auditimin e kryer në Prokurorinë e Përgjithshme, edhe pse raportet i përkasin së njëjtës periudhë. Gjithashtu, në këtë rast gjen zbatim neni 30, shkronja “a”, i Kodit të Procedurave Administrative, pasi kryetari i KLSH-së ka pasur interes personal të drejtpërdrejtë në këtë çështje, pasi me rritjen e pagës së magjistratit rritet edhe paga e tij.

26.3. *Për nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 50/2021:*

26.3.1. Në parashikimin fillestar të nenit 12, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 termi i përdorur ka qenë “pagën për funksion”, të cilin nuk e gjejmë në VKM-në nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në

Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar (VKM nr. 545/2011), në fuqi në kohën e miratimit të këtij ligji, dhe VKM-në nr. 187/2017, aktualisht në fuqi, por e vetmja situatë e ngjashme me të është “shtesa për funksion”. Ndaj duhet bërë interpretimi sipas qëllimit të ligjvënësit, e për këtë qëllim marrin rëndësi punimet përgatitore të normës. Termi “pagën për funksion” nuk është i cituar në asnjë akt ligjor e nënligjor, por në të gjitha materialet e diskutuara për miratimin e ligjit, për rrjedhojë edhe në miratimin e dokumenteve strategjike dhe të paketës së Reformës në Drejtësi, si dhe në miratimin e Dokumentit Afatmesëm Buxhetor, është marrë në konsideratë vlera e klasës II, kategoria II-a e VKM-së nr. 187/2017, pra vlera e “shtesës për pozicion”.

- 26.3.2. Nisur nga përkufizimi “pagë individuale”, kjo pagë nuk merret në asnjë rast për referencë në llogaritjen e pagave të pozicioneve të tjera, pasi është një pagë që ndryshon në varësi të individit. Ndaj si pagë reference është marrë vlera e shtesës së pagës për pozicion, e cila nuk ndryshon në asnjë rast për pozicionin ose funksionin e drejtorit të përgjithshëm, pavarësisht nga formimi universitar, pasuniversitar dhe vjetërsia në punë. Kësaj page, sipas nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, i shtohet paga e përkatësisë në grup dhe paga e vjetërsisë në punë për magjistratin, dy elemente që, gjithashtu, ndryshojnë në varësi të pozicionit ku ushtrohet funksioni dhe vjetërsia në punë dhe që përfaqësojnë pagën individuale të magjistratit, e cila është në harmoni me VKM-në nr. 187/2017. Edhe vetë KLGJ-ja në kërkesat buxhetore për vitet 2019, 2020 dhe 2021 e ka barazuar termin “pagë për funksion” me atë “shtesë për pozicion”, interpretim që është pranuar edhe nga Këshilli i Ministrave kur ka paraqitur projektbuxhetet vjetore, që më pas janë miratuar me ligj nga Kuvendi. Këto tri organe zbatuese të normës kanë konkluduar se megjithëse ka një ndryshim në terminologji, ai nuk është i tillë që të ndryshojë kuptimin e qëllimit të ligjvënësit.
- 26.3.3. Bazuar në interpretimin sistematik të dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në këtë rast, pagë referuese bazë, sipas nenit 12, pika 5, shkronja “a”, është “shtesa për pozicion” sipas lidhjes nr. 1 të VKM-së nr. 187/2017, që i korrespondon

vlerës 118,100 lekë. Neni 2, shkronja “j”, i ligjit nr. 96/2016 përcakton se “paga bruto fillestare” përfaqëson pagën referuese bazë dhe shtesën e pagës në grup. Për të përcaktuar pagën referuese bazë ligji ka referuar në pagën e funksionit të nëpunësit civil, që nuk është gjë tjetër veçse shtesa për pozicion që përfiton nëpunësi që mban pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri.

26.4. *Për nenin 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996, të ndryshuar me nenin 1, të ligjit nr. 166/2020:*

26.4.1. Ndryshimet e kundërshtuara kanë ndodhur në skemën e pensionit suplementar dhe jo në atë bazë të pensioneve, e cila ka mbetur e pandryshuar, për rrjedhojë nuk jemi përpara cenimit të ndonjë të drejte kushtetuese. Edhe jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se natyra e sigurimit shoqëror suplementar është e ndryshme nga sigurimi shoqëror bazë, që është një e drejtë kushtetuese ekonomiko-sociale. Ndryshimi i skemës referuese është pasojë e miratimit të paketës kushtetuese dhe ligjore të reformës në drejtësi. Skema e pensioneve suplementare përballohet kryesisht nga buxheti i shtetit (në masën 75%), ndaj një ndërhyrje e tillë është e justifikuar për ruajtjen e qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit.

26.4.2. Në lidhje me pretendimin e cenimit të parimit të barazisë, rezulton se asnjë funksionar tjetër shtetëror nuk merr më shumë pension suplementar se sa Presidenti. Duke marrë në konsideratë kontributet reale të paguara nga magjistratët para dhe pas datës 31.12.2018, të drejtat e tyre nuk cenohen. Përkundrazi, mosmarrja parasysh e kontributeve që janë paguar realisht do të sillte një trajtim jo të barabartë mes vetë magjistratëve. Nuk cenohet as parimi i pavarësisë së gjyqësorit, pasi pensioni suplementar nuk ndikon në punën e përditshme të gjyqtarëve. Paga dhe pensioni i pleqërisë nuk preken, ndërsa pensioni suplementar përlloraget mbi bazën e kontributeve që realisht janë paguar, për rrjedhojë as ai nuk preket.

27. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka prapësuar sa më poshtë vijon:

27.1. *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese*

27.1.1. Nisma për paraqitjen e kësaj kërkesë nuk është marrë nga standardet dhe parimet kushtetuese, por nga raporti i KLSH-së, i hartuar pas auditimit tematik të zhvilluar në KLGJ. Kërkuesi nuk ka argumentuar cenimin e të drejtave kushtetuese materiale, por argumentet e tij, në thelb, lidhen me çështje të

kuptimit e zbatimit të normës ligjore dhe jo me përmbajtjen e saj, çka del jashtë juridiksionit kushtetues.

27.2. *Për legjitimimin e kërkuarit*

27.2.1. Kërkuari nuk legjitimohet për shfuqizimin në tërësi të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, pasi kjo dispozitë nuk u drejtohet vetëm gjyqtarëve, interesat e të cilëve mbrohen ai, por të gjithë magjistratëve, përfshirë prokurorët, drejtuesit e prokurorive, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Për rrjedhojë, nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë mes veprimtarisë që ushtron kërkuari, sipas statutit, dhe pretendimeve për antikushtetutshmërinë në tërësi të normës.

27.3. *Për nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 50/2021:*

27.3.1. Nga krahasimi i normës së mëparshme ligjore me atë objekt shqyrtimi dhe bazuar në interpretimin teleologjik të tyre, formula e llogaritjes së pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore e të prokurorisë është e njëjtë që nga data 01.01.2019, duke referuar vetëm në vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri. Për rrjedhojë, paga e magjistratit nuk është ulur/pakësuar në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës.

27.3.2. Neni 12 i ligjit nr. 96/2016, që përcakton elementet e pagës bruto, ka përcaktuar si një prej tyre “pagën referuese bazë”, jo në vlerë konkrete, por me referim në pagën për funksion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 187/2017. Elementi “shtesa për pozicion” përbën elementin bazë të pagës mujore dhe referimi në të ka qenë qëllimi i ligjvënësit në kohën e hartimit të kësaj dispozite. Ligjvënësi nuk ka pasur si synim që referimi për efekt të pagës referuese bazë të bëhet për të gjithë pagën mujore të pozicionit të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, e cila përfshin pagën e grupit dhe shtesën e pozicionit, por vetëm për këtë të fundit.

27.3.3. Saktësimi i termit “pagë për funksion” në “shtesë për funksion” nuk sjell asnjë efekt dhe ndryshim në vlerën e pagës së magjistratëve, për pasojë nuk e pakëson atë. Duke qenë të ndërgjegjshëm që terminologjia juridike e përdorur në këtë dispozitë nuk ishte e qartë, nisur edhe nga gjetjet e rekomandimet e KLSH-së, që përcaktonin një mënyrë tjetër zbatimi që nuk përkonte me

qëllimin e ligjvënësit, Kuvendi ka qenë i detyruar të saktësojë/qartësojë terminologjinë juridike, në funksion të rritjes së qartësisë ligjore.

27.3.4. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në drejtim të pritshmërive të ligjshme, përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar nuk ndikon në sistemin e përlllogaritjes së pagave, që do të vijojnë të përlllogariten sikurse është vepruar që prej datës 01.01.2019. Ndryshimi ligjor i kundërshtuar nuk ka karakter substancial, por ofron më tepër siguri dhe qartësi dhe nuk sjell rezultate të papritshme ose pasoja të paparashikueshme për magjistratët, për sa kohë që zbatohet i njëjti sistem përlllogaritjeje i pagës referuese bazë.

27.3.5. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës, për sa kohë që norma ligjore e kundërshtuar nuk cenon nenin 138 të Kushtetutës, përkundrazi ndjek të njëjtin qëllim legjislativ si dispozita e mëparshme, duke synuar vetëm saktësimin e terminologjisë, pa ndikuar në mënyrën e përlllogaritjes së pagës së magjistratit.

27.4. *Për nenin 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996, të ndryshuar me nenin 1, të ligjit nr. 166/2020:*

27.4.1. Për të pasur një raport sa më të drejtë të përfitimit me kontributet, paga referuese është kufizuar me atë të Presidentit, si funksioni më i lartë i përcaktuar me VKM-në nr. 548, datë 27.07.2016 “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit.” (VKM nr. 548/2016). Skema e pensioneve suplementare subvencionohet në masën mbi 75% nga buxheti i shtetit dhe ajo mund të kufizohet në përputhje me politikën shtetërore. Edhe kontributi i sigurimeve shoqërore derdhet sipas legjislacionit në fuqi mbi një kufi maksimal dhe jo mbi masën e pagës bruto, sikurse sigurimet shëndetësore.

27.4.2. Ndarja e periudhave para dhe pas datës 01.01.2019 është bërë për arsye se në këtë datë hynë në fuqi ndryshimet e sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magjistratët. Duhet të jetë i qartë dallimi midis skemave tërësisht kontributive me atë që subvencionohet nga buxheti i shtetit, në të cilën, me qëllim ruajtjen e balancave të nevojshme për mirëfunksionimin e sistemit buxhetor, vendosen kushte dhe kufizime.

27.4.3. Në lidhje me shkronjën “c” është parashikuar paga e ponderuar bazuar në pagat përpara reformës në drejtësi dhe pas saj. Parimi i pensioneve suplementare

është kontributiv, për këtë arsye është përcaktuar që përfitimet të paguhen bazuar në pagat mbi të cilat janë paguar kontributet suplementare. Pra, ndarja e periudhave të përfitimit është e lidhur me kontributet e derdhura në këto periudha.

28. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, ka paraqitur parashtrime vetëm në lidhje me kërkimin e parë të kërkesës, për nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 50/2021:

28.1. Termi “pagë për funksion”, i parashikuar në versionin fillestar të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, nuk gjendet as në VKM-në nr. 187/2017 as në ndonjë akt tjetër ligjor a nënligjor. Edhe referimi i kategorisë së pagës në “kategoria e parë, klasa e tretë” nuk përputhej me kategorinë e pozicionit të “drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të” sipas VKM-së nr. 187/2017. Në përlllogaritjen e pagave KLGJ-ja i është referuar përmbajtjes së ligjit për statusin e magjistratit, VKM-së nr. 187/2017, materialeve të diskutuara për miratimin e tij dhe paketës së reformës në drejtësi, si dhe konsultimeve të bëra me Ministrinë e Financave për fazat 1 dhe 2 të dokumentit të projektbuxhetit për sistemin e drejtësisë. Sipas këtyre akteve, ligjvënësi ka referuar vlerën e klasës II, kategoria II-a të VKM-së nr. 187/2017 ose thënë ndryshe vlera e “shtesës për pozicion” e kësaj klase prej 118,100 lekë.

28.2. Në përfundim të kontrollit të ushtruar me autorizim të KLGJ-së, KLSH-ja bëri një interpretim të ndryshëm të përlllogaritjes së pagës referuese bazë të funksionit të magjistratit. Në vijim të këtyre gjetjeve, KLGJ-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me kërkesë për fonde buxhetore shtesë për vitin buxhetor 2021. Kjo e fundit ka kthyer përgjigje se përveçse interpretimi i KLSH-së është i gabuar, duke paraqitur argumentet teknike në lidhje me interpretimin e dispozitës ligjore, ai sjell efekte të papërbalueshme për buxhetin e shtetit. Ndërkohë, me vendime të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është interpretuar llogaritja e pagës referuese bazë për funksionin e magjistratit në të njëjtën mënyrë me KLSH-në.

28.3. KLGJ-ja, në lidhje me ndryshimet e propozuara të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, ka shprehur qëndrimin se: i) formulimi nuk është korrekt në raport me VKM-në nr. 187/2017, për sa u përket përcaktimeve për kategorinë dhe klasën që i korrespondojnë pozicionit të drejtorit të drejtorisë së

përgjithshme ose çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri;
ii) për të garantuar përcaktimin e nenit 138 të Kushtetutës është e domosdoshme që referimi për pagën referuese të magjistratit të bëhet te paga e një funksionari publik, paga e të cilit përcaktohet nga ligji; iii) ndryshimi i propozuar, pikërisht referenca “pagë për funksion” me “shtesë për pozicion” duket që prek pagën referuese të magjistratit duke e ulur atë, ndaj bie ndesh me Kushtetutën.

28.4. Me vendimin nr. 351, datë 27.07.2022, KLGJ-ja ka zbatuar rekomandimin e KLSH-së lidhur me përlogaritjen e pagës, pikërisht të pagës referuese, për magjistratët dhe këshilltarët ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës, pagesë e cila duhet të bëhej për periudhën nga 01.01.2019 deri më 28.05.2021, kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 50/2021.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

A.1. Për legjitimitimin formal

29. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka kundërshtuar legjitimitimin formal të kërkuessit për dy arsye: *së pari*, edhe pse në hyrje të kërkesës është shënuar “bordi drejtues”, nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të këtij organi për t’iu drejtuar Gjykatës; *së dyti*, bazuar në nenin 33 të statutit të Unionit, mandati i organeve të zgjedhura me vendimin e datës 18.04.2018, ka përfunduar më 18.04.2021, pra para vënies në lëvizje të Gjykatës, dhe kërkuessi nuk ka paraqitur ndonjë akt që të provojë zgjedhjen e organeve të reja drejtuese gjatë kësaj periudhe.

30. Sipas kërkuessit, Unioni është një organizatë e madhe që funksionon rregullisht dhe ajo nuk është shkrirë, në përputhje me parashikimet e nenit 43 të statutit. Kohëzgjatja e kësaj shoqate është e pakufizuar dhe bordi drejtues vazhdon të funksionojë në përputhje me parimin e funksionalitetit e të vazhdimësisë.

31. Gjykata vëren se Unioni është subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2171, datë 04.02.2008, për rrjedhojë përfshihet në rrethin e subjekteve që përcakton neni 134, pika 1, shkronja “h”, i Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

32. Gjykata konstaton se kërkesa, edhe pse në krye të saj shënohet “bordi drejtues”, është nënshkruar nga zoti Gerd Hoxha, si kryetar i këtij bordi. Sipas neneve 9 dhe 12 të aktit

të themelimit dhe neneve 22 e 39 të statutit të shoqatës, organet drejtuese të saj janë, veç të tjerave, bordi drejtues dhe kryetari i bordit drejtues. Ky i fundit është organi që përfaqëson shoqatën në marrëdhënie me të tretët, ndërkohë që këto akte nuk përmbajnë ndonjë parashikim të shprehur në lidhje me mënyrën ose formën për kundërshtimin e akteve në Gjykatën Kushtetuese. Në praktikën e saj Gjykata nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin formal dhe procedural të kësaj shoqate, pavarësisht se cili nga organet drejtuese ka marrë nismën për t'iu drejtuar Gjykatës (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, në aspektin formal kryetari i bordit drejtues të Unionit legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës pa qenë e nevojshme paraqitja e ndonjë akti të organeve të tjera të shoqatës për të provuar vullnetin e saj për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

33. Në lidhje me pretendimin për përfundimin e mandatit të organeve drejtuese të Unionit, Gjykata konstaton se sipas parashikimeve të nenit 11 të aktit të themelimit dhe nenit 33 të statutit, bordi drejtues zgjidhet nga asambleja e përgjithshme për një mandat 3-vjeçar, kurse sipas nenit 34 të statutit, anëtari i bordit drejtues që ka fituar më shumë se 50% të votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet automatikisht edhe kryetar i tij. Referuar vërtetimit të zyrës së regjistrimit të OJF-ve, me vendimet e Asamblesë të Përgjithshme të datave 23.02.2008 dhe 02.07.2011 janë zgjedhur anëtarët e bordit drejtues, kurse me vendimet e datave 06.10.2014 dhe 17.05.2018 është zgjedhur kryetari i këtij bordi. Për vitin 2021 nuk rezulton që Unioni të ketë zgjedhur organet e reja drejtuese.

34. Gjykata, referuar historikut të mësipërm, konstaton se organet drejtuese të Unionit janë zgjedhur në mënyrë periodike, ndonëse nuk kanë respektuar në mënyrë strikte parashikimet statutoare për zgjedhjen e tyre çdo 3 vjet. Gjykata konstaton, gjithashtu, se sipas neneve 43 dhe 44 të statutit të shoqatës, kohëzgjatja e saj është e pakufizuar dhe ajo e mbyll aktivitetin me vendim të marrë me shumicë të cilësuar të anëtarëve të asamblesë së përgjithshme, që sipas nenit 10 të aktit të themelimit dhe nenit 23 të statutit është organi më i lartë i shoqatës. Gjatë gjykimit nuk rezultoi që shoqata kërkuese të mos funksionojë më si organizatë ose që të jetë shkrirë, dhe as nuk rezultuan të dhëna se përfaqësuesi i saj në këtë gjykim nuk ushtron më detyrat si kryetar i Unionit.

35. Gjykata vëren se në mbështetje të pretendimit të tij, subjekti i interesuar, Kuvendi, ka referuar vendimin nr. 21, datë 28.04.2021 të kësaj Gjykate, me të cilin është vendosur rrezimi i kërkesës për shkak të mungesës së legjitimitetit të organit përfaqësues të shoqatës kërkuese, të cilit i kishte mbaruar mandati. Gjykata vlerëson se ky vendim nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi në atë çështje u konstatua jo vetëm një periudhë shumë e gjatë kohore në

të cilën organi përfaqësues kishte vepruar në mungesë të mandatit të dhënë, por edhe se gjatë kësaj periudhe shoqata kërkuese kishte zgjedhur një kryetar tjetër, i cili e kishte përfaqësuar atë në marrëdhëniet me të tretët.

36. Për sa më sipër, bazuar në parimin e vazhdimësisë së organeve drejtuese të personit juridik, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë shkak për të vënë në dyshim materializimin e vullnetit të shoqatës kërkuese dhe tagrat e përfaqësimit në këtë gjykim, ndaj pretendimi i subjektit të interesuar, Kuvendit, për mungesën e legjitimitetit formal të kërkuesit, është i pabazuar.

A.2. Për legjitimitetin substancial

37. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, dispozitat e kundërshtuara nuk u drejtohen vetëm gjyqtarëve, interesat e të cilëve mbrohen kërkuesi, ndaj nuk provohet lidhja e drejtpërdrejtë mes veprimtarisë që ai ushtron dhe pretendimeve për antikushtetutshmëri në tërësi të normës, e cila është e zbatueshme për të gjithë magjistratët, përfshirë prokurorët, drejtuesit e prokurorive, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Po kështu, nisma për paraqitjen e kësaj kërkesë nuk është marrë nga standardet dhe parimet kushtetuese, por nga raporti i KLSH-së, i hartuar pas auditimit tematik të zhvilluar në KLGJ. Kërkuesi nuk ka argumentuar cenimin e të drejtave kushtetuese materiale, por argumentet e tij, në thelb, lidhen me çështje të kuptimit dhe zbatimit të normës ligjore dhe jo me përmbajtjen e saj, për rrjedhojë çështja del jashtë juridiksionit kushtetues.

38. Sipas kërkuesit, ai legjitimohet, pasi dispozitat e kundërshtuara cenojnë standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me parimet e shtetit të së drejtës, të sigurisë juridike, pavarësisë së pushtetit gjyqësor e statusin e gjyqtarëve, për rrjedhojë ekziston lidhja e domosdoshme mes veprimtarisë së tij dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Për sa i përket legjitimitetit për shtesën e objektit, shkronjën “a” të paragrafit të dytë të pikës 7 të nenit 1 të ligjit nr. 8097/1996, sipas kërkuesit, e drejta për të mbrojtur edhe interesat e ish-gjyqtarëve buron nga fryma dhe kontributi që ata kanë dhënë në sistemin e drejtësisë gjatë kohës që kanë ushtruar detyrën dhe kanë qenë anëtarë të kësaj shoqate, si dhe duke pasur parasysh se pensioni suplementar është një përfitim që buron nga statusi i magjistratit dhe u mundëson të vazhdojnë të jetojnë me dinjitet.

39. Çështjen e legjitimitetit Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato

kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 32, datë 27.10.2021; nr.14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, subjektet e kushtëzuara, ku përfshihen edhe organizatat, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve. Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje gjykimin kushtetues duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston te e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 32, datë 27.10.2021; nr.14, datë 21.03.2014; nr.37, datë 13.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në lidhje me interesin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, sipas nenit 1 të statutit të tij, Unioni kontribuon në mbrojtjen e interesave profesionale, shoqërore, intelektuale e materiale të gjyqtarëve, kurse sipas nenit 8, duke bashkuar gjyqtarët shqiptarë, ka për qëllim, mes të tjerash, “*të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*”. Në lidhje me subjektet me legjitimitet të kushtëzuar, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që ato të provojnë se përfaqësojnë të gjithë profesionistët e asaj fushe, pasi, në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimitimin e tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 11, datë 06.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, duke qenë se qëllimi i kërkuesit është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të gjyqtarëve, është e drejta e tij që në çdo rast kur konstaton se një normë cenon interesat e tyre, në tërësi ose në veçanti, t’i drejtohet Gjykatës me kërkesë për

shfuqizimin e normës konkrete (*shih vendimin nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata ka legjitimuar edhe më parë Unionin për kundërshtimin në tërësi të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, përfshirë parashikimet që rregullojnë pagat e magjistratëve, duke vlerësuar se ky ligj ka për objekt përcaktimin e statusit të magjistratëve dhe se dispozitat e tij i referohen magjistratit pa bërë asnjë dallim midis gjyqtarit dhe prokurorit (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, duke qenë se objekti i nenit 12, pika 5, shkronja “a” është përcaktimi i njërës prej elementeve të pagës bruto, rregullim që zbatohet dhe prek drejtpërdrejt e në mënyrë të njëjtë të gjithë magjistratët, pra edhe anëtarët e kësaj shoqate, përlligjet interesi i këtij subjekti për të kundërshtuar përmbajtjen e kësaj dispozite në tërësinë e saj.

43. Për sa u takon dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 8097/1996, Gjykata konstaton se ato prekin disa kategori magjistratësh, përfshirë ata që kanë ushtruar detyrën deri më 31.12.2018 (neni 1, pika 7). Këto kategori përfitojnë pension suplementar sipas kushteve të përcaktuara, nëse kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike (nenet 8-9). Në këtë drejtim, Gjykata vëren se statusi i magjistratit rregullohet nga ligji nr. 96/2016, ai gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion (neni 1, pika 2) dhe zgjat deri në mbarimin e tij sipas rasteve të përcaktuara në ligj (neni 64). Statusi i magjistratit përfshin edhe të drejtën për pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit, të njëjtë me funksionarët e parashikuar nga ky ligj, sipas ndarjes së tyre në grupe (neni 21). Gjykata, duke vlerësuar se e drejta për pension suplementar është një nga përfitimet që rrjedh nga statusi i magjistratit, të cilin ata e gëzojnë edhe pas mbarimit të mandatit të tyre, pavarësisht momentit se kur lind kjo e drejtë, çmon se ajo përfshihet në rrethin e të drejtave që Unioni ka për mision të mbrojtë në gjykimin kushtetues.

44. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi provon interesin e tij për kundërshtimin e dispozitave objekt kërkese në tërësinë e tyre.

45. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për të dyja kërkimet objekt kërkese, në kuptim të përmbajtjes së nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e dispozitave të kundërshtuara.

46. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* në kërkesë është parashtruar se përmbajtja e dispozitave të kundërshtuara cenon garancitë kushtetuese të parashikuara në nenin 138 të Kushtetutës të lidhura me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parimin e

sigurisë juridike, në drejtim të të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, parimin e hierarkisë së akteve, si dhe parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Në ndryshim nga sa ka prapësuar subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave, se argumentet e kërkesës lidhen me çështje të kuptimit dhe zbatimit të normës ligjore dhe jo me përmbajtjen e saj, Gjykata vlerëson se referimet e kërkuarit në lidhje me mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore nga KLSH-ja dhe KLGJ-ja ose përplasjet mes dispozitave të ligjeve objekt kërkesë, janë paraqitur prej tij si argumente për antikushtetutshmërinë e normave të kundërshtuara, kurse referuar thelbit të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, ato kanë natyrë kushtetuese, pasi kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e dispozitave të kundërshtuara me parimet dhe normat kushtetuese.

47. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se pavarësisht mënyrës se si janë formuluar pretendimet e kërkuarit, ato do të vlerësohen vetëm në këndvështrim të respektimit të garancive që burojnë nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për garancitë e nenit 138 të Kushtetutës

48. Neni 138 i Kushtetutës parashikon: *“Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”.*

49. Gjykata ka pohuar se kjo normë kushtetuese përcakton një nga elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, pikërisht trajtimin financiar, pa të cilin nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (*shih vendimin nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo pavarësi, e parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk është privilegj, por një nga detyrimet më të rëndësishme të gjyqtarëve dhe gjykatave që buron nga të drejtat e garantuara kushtetutshëmrisht individit që pretendon cenimin e të drejtave dhe lirive të tij, për të pasur një arbitër të paanshëm të mosmarrëveshjes, që do e

zgjdhë atë në themel sipas Kushtetutës dhe ligjeve. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur (*shih vendimet nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Për sa i përket nivelit të pagës, si një nga elementet me natyrë financiare të statusit të gjyqtarit, Gjykata ka theksuar se shteti ka detyrimin të vendosë paga të tilla, të cilat jo vetëm të jenë në përputhje me këtë status dhe atë të vetë pushtetit gjyqësor, funksionet e ushtruara dhe përgjegjësitë përkatëse, por edhe t'i mbrojnë gjyqtarët nga presionet që synojnë të influencojnë vendimet e tyre dhe, më në përgjithësi, sjelljen e tyre brenda juridiksionit të cilit i përkasin. Niveli i pagës duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një pavarësi të vërtetë ekonomike dhe ajo nuk duhet të varet nga rezultatet e punës dhe nuk mund të ulet gjatë qenies së tij në detyrë (*shih vendimin nr. 26, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Siguria në lidhje me pagën dhe me ushtrimin e qëndrueshëm të detyrës krijon kushtet e nevojshme që gjyqtarët të zbatojnë ligjin në mënyrë të drejtë e të paanshme (*shih vendimet nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Duhet evidentuar se përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës është ndryshuar në vitin 2016, si pjesë e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore që u përfshinë në paketën e Reformës në Drejtësi. Gjykata ka theksuar se parashikimi aktual, përveçse njeh dhe garanton në nivel kushtetues elementet më të rëndësishme të statusit të gjyqtarit, ka përcaktuar në mënyrë shteruese tre kritere që justifikojnë uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, ku kriteri i parë nuk lidhet me vullnetin ose sjelljen e gjyqtarit, kriteri i dytë është rrjedhojë e ligjit (mbarimi i mandatit *ipso lege*), kurse kriteri i tretë lidhet ngushtësisht me sjellje/situata të tilla që përbëjnë shkelje disiplinore ose me cilësitë profesionale të magjistratit (pamjaftueshmëria profesionale) (*shih vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nisur nga standardet kushtetuese të lartpërmendura, Gjykata vëren se përmbajtja aktuale e nenit 138 të Kushtetutës jo vetëm që përcakton në mënyrë shteruese rastet e uljes së pagës dhe përfitimeve të tjera të gjyqtarit, por, për më tepër, në shkronjën “a” të tij e përkufizon në mënyrë të shprehur arsyen publike të uljes së pagës dhe përfitimeve, duke e lidhur me nevojën e marrjes së masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare. Kjo

dispozitë kushtetuese nuk parashikon delegim të shprehur për ligjvënësin për rregullimin e rasteve të tjera dhe as për arsyen publike të uljes së pagave dhe përfitimeve të gjyqtarit, si masë të përgjithshme, që do të thotë se këto dy çështje i përkasin rezervës absolute kushtetuese. Po ashtu, Gjykata vëren se në kushtet kur këto dy çështje për gjyqtarët, në ndryshim nga funksionarët e tjerë publikë ose nga individët, janë të rregulluara drejtpërdrejt në nivel kushtetues nga neni 138, në kontrollin kushtetues të respektimit të pagës dhe përfitimeve që rrjedhin nga statusi i tyre, nuk është e nevojshme analiza e kritereve të kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës ose të parimit të sigurisë juridike, në aspektin e pritshmërive të ligjshme.

54. Gjykata konstaton se pjesë e paketës së reformës në drejtësi ishte, mes të tjerash, edhe rishikimi domethënës i sistemit të pagave, përfitimeve dhe shpërblimeve të tjera të magjistratit, me qëllim përmirësimin e trajtimit të tyre në përputhje me përvojën në punë, zhvillimin e karrierës dhe vështirësive. Sipas relacionit shpjegues të projektligjit nr. 96/2016, paga dhe trajtimi financiar i mëparshëm nuk mbanin parasysh në masë të mjaftueshme dinjitetin e detyrës e të profesionit, natyrën e përgjegjësive të funksionit gjyqësor, shkallën e vështirësive në përmbushjen e tij, numrin e lartë të papajtueshmërive dhe ndalimeve të posaçme për të kryer veprimtari të tjera që sjellin të ardhura, nevojën për ta mbrojtur nga presionet dhe ndikimet në veprimtarinë e tij gjyqësore e në sjelljen e tij në tërësi, si dhe nevojat e integritit social të tij dhe të familjes në shoqëri. Kuadri i ri kushtetues e ligjor, duke parashikuar rritjen domethënëse të përfitimeve të magjistratit, synoi të ofrojë një skemë reale dhe dinjitoze të shpërblimit të magjistratit dhe garantimin e një pagë që i korrespondon dinjitetit të profesionit dhe përgjegjësive të detyrës. Objektivi i mësipërm i ligjvënësit është sanksionuar në nenin 11 të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tij (*shih vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

B.1.1. Për cenimin e pagës së magjistratit

55. Kërkuesi ka parashtruar se edhe pse neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016 ishte i qartë, ai u riformulua sipas zbatimit të gabuar të kësaj dispozite, duke sjellë në fakt uljen e pagës së magjistratëve. Ndryshimi ligjor nuk u diktua dhe nuk u iniciua për ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 138, por për të “korrigjuar” gabimin e bërë në përlllogaritjen e KLGJ-së dhe për të sanksionuar si të ligjshme e korrekte mënyrën e interpretimit të bërë deri në atë moment. Duke ndryshuar me efekt negativ pagën nuk

respektohen garancitë kushtetuese të paprekshmërisë së pagës, sipas nenit 138 të Kushtetutës, të lidhura edhe me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor e atë të shtetit të së drejtës dhe, në kuptim të këtij të fundit, me parimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme të magjistratëve.

56. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, paga e magjistratit nuk është ulur, por ndryshimet ligjore kanë synuar të sqarojnë më mirë normën. Në aktet nënligjore nuk gjendet nocioni “paga për funksion” dhe nga krahasimi i terminologjisë e vetmja situatë e ngjashme me këtë term është ai “shtesë për funksion”. Referimi në “shtesën për pozicion” është objektiv, pasi është një element i qëndrueshëm dhe jo i ndryshueshëm në varësi të vjetërsisë ose kualifikimit të drejtorit të përgjithshëm në Kryeministri. Neni 12, pika 5, i ligjit nr. 96/2016 ka parashikuar elementet e pagës së magjistratit, ku paga referuese bazë për funksion është elementi i pandryshueshëm që jepet për shkak të funksionit dhe përbën njëkohësisht bazën mbi të cilën llogariten elementet e tjera, siç janë paga e përkatësisë në grup dhe paga e vjetërsisë në punë, dy elemente që ndryshojnë në varësi të pozicionit ku ushtrohet funksioni dhe eksperiencia ose vjetërsia në punë, që përbëjnë pagën individuale të magjistratit.

57. Këshilli i Ministrave ka prapësuar se nga krahasimi i normave ligjore dhe bazuar në interpretimin teleologjik të tyre, formula e llogaritjes së pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore e të prokurorisë është e njëjtë që nga data 01.01.2019, duke referuar vetëm në vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri. Për rrjedhojë, paga e magjistratit nuk është ulur/pakësuar. Dispozita ligjore e kundërshtuar nuk ndryshon formulën e përlllogaritjes së pagës referuese bazë, por vetëm saktëson/qartëson terminologjinë juridike të përdorur sipas VKM-së nr. 187/2017. Duke qenë se terminologjia juridike e përdorur në këtë dispozitë nuk ishte e qartë, nisur edhe nga gjetjet e rekomandimet e KLSH-së, Kuvendi ka qenë i detyruar ta saktësojë/qartësojë atë në funksion të rritjes së qartësisë ligjore, por duke zbatuar të njëjtin sistem përlllogaritjeje të pagës referuese bazë.

58. Sipas subjektit të interesuar, KLGJ-së, termi “pagë për funksion” nuk gjendet as në VKM-në nr. 187/2017, as në ndonjë akt ligjor ose nënligjor tjetër. Edhe referimi i kategorisë së pagës në “kategoria e parë, klasa e tretë” nuk përputhet me kategorinë e pozicionit të “drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të”, sipas kësaj VKM-je. Në lidhje me ndryshimet e propozuara të kësaj dispozite, KLGJ-ja ka shprehur qëndrimin se formulimi nuk është korrekt në raport me VKM-në nr. 187/2017 dhe se referimi i pagës referuese duhet bërë te paga e një funksionari

publik, e cila përcaktohet nga ligji, pasi referimi vetëm te shtesa për pozicion prek pagën e magjistratit, duke e ulur atë.

59. Në vështrim të standardeve kushtetuese dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret janë cenuar garancitë në lidhje me pagën, të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës.

60. Për këtë qëllim, Gjykata do të krahasojë rezultatin që neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016 jepte në formulimin fillestar në raport me rezultatin pas ndryshimeve të tij, që kundërshtohet në këtë gjykim. Në kushtet kur kjo dispozitë ligjore referon te legjislacioni i shërbimit civil, është e nevojshme të shqyrtohet edhe përmbajtja e këtij të fundit. Duke iu referuar kontekstit historik, si dhe mbi bazën e një interpretimi gjuhësor, sistematik, teleologjik dhe logjik, Gjykata, nëpërmjet kësaj analize dhe interpretimi, synon të nxjerrë kuptimin e përmbajtjes së normës objekt gjykimi në momentin e miratimit, në mënyrë që të arrijë në një përfundim të drejtë në lidhje me qëllimin e ligjvënësit e më tej në lidhje me bazueshmërinë e pretendimit të kërkuesit për cenimin e garancive të parashikuara në nenin 138 të Kushtetutës.

61. Ligji nr. 96/2016 në nenin 2, shkronja “j”, përkufizon “pagën bruto fillestare” të magjistratit, e cila përfaqëson pagën referuese dhe shtesën e pagës në grup. Në vijim, neni 11, pika 2, parashikon se paga e magjistratit përcaktohet në bazë të katër kritereve: a) shkallës së gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin; b) vjetërsisë në ushtrimin e funksionit; c) fushës së veçantë të kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin; ç) pozicionit drejtues. Këto kritere janë materializuar në nenin 12, sipas të cilit paga e magjistratit caktohet sipas përkatësisë së magjistratit në grupin dhe nivelin e pagës (pika 1). Mbi bazën e këtij parimi, më tej neni 12 përcakton strukturën e grupeve sipas funksioneve (pika 2), masën e shtesës për vjetërsi në funksion (pikat 3 dhe 4), si dhe nivelin e pagës përmes detajimit të elementeve të pagës mujore bruto (pika 5). Elementet e pagës mujore bruto janë paga referuese bazë, shtesa për pagën në grup, që llogaritet mbi pagën referuese bazë, shtesa për vjetërsi, e llogaritur mbi pagën referuese bazë, shtesa për pozicion drejtues dhe shtesa për vështirësi pune. Duke mbajtur në konsideratë pretendimet dhe prapësimet e palëve, Gjykata vëren se objekti i gjykimit kushtetues lidhet me konceptin e pagës referuese bazë të magjistratit.

62. Në momentin e miratimit të ligjit nr. 96/2016, neni 12, pika 5, shkronja “a”, parashikonte se “paga referuese bazë” për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë “është e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo

pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave”. Bazuar në përmbajtjen e kësaj norme, për të shpjeguar konceptin e pagës referuese bazë të magjistratit është e nevojshme të analizohet kuptimi i shprehjeve: i) *kategoria dhe klasa sipas klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil*; ii) *paga për funksion* që i përket këtij klasifikimi.

63. Duke vijuar me analizën e kuadrit ligjor për shërbimin civil, Gjykata vëren se ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ligji nr. 152/2013) i ka klasifikuar pozicionet e shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit (neni 19, pikat 1-4). Kështu, pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori nëpunësish: a) i lartë drejtues; b) i mesëm drejtues; c) i ulët drejtues; ç) ekzekutiv. Në kategorinë e nëpunësit të lartë drejtues përfshihen pozicionet: a) sekretar i përgjithshëm; b) drejtor departamenti; c) drejtor drejtorie të përgjithshme; ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat. Më tej, ligji e ndan secilën kategori në klasa, por duke mos bërë klasifikimin në klasa të pozicioneve të punës që bëjnë pjesë në to.

64. Ndërkohë, në bazë të nenit 19, pika 9, të ligjit nr. 152/2013, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e pavarura të administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” (VKM nr. 142/2014). Sipas këtij akti nënligjor, për pozicionet e punës të kategorisë së parë (kategoria I), që përfshin nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues, klasat e zbatueshme janë tre. Për sa u përket pozicioneve të punës në Kryeministri, në klasën e parë është përfshirë pozicioni “sekretar i përgjithshëm në Këshillin e Ministrave”, në klasën e dytë është përfshirë pozicioni “drejtor departamenti”, ndërsa në klasën e tretë është përfshirë pozicioni “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri”. Si pozicione të barasvlershme me të, në klasën e tretë kjo VKM ka përcaktuar, ndër të tjera, pozicionin e sekretarit të përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore.

65. Për sa më lart, Gjykata konstaton se në ligjin nr. 152/2013 dhe VKM-në nr. 142/2014, pozicioni “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri” dhe pozicionet e barasvlershme me të klasifikohen në kategorinë e parë, klasa e tretë. Për rrjedhojë, shprehja “kategoria dhe klasa sipas klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil”, për përcaktimin e pagës referuese bazë të magjistratit, rezulton e përcaktuar qartë dhe në mënyrë të plotë në referimin që përmban shkronja “a” e pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016 në kohën e miratimit të tij. Thënë ndryshe, klasifikimi “kategoria e parë, klasa e tretë”, i bërë sipas kësaj norme ligjore, nënkupton pozicionimin më të ulët brenda nivelit më të lartë të nëpunësve civilë.

66. Lidhur me shprehjen “pagë për funksion”, neni 12 i ligjit nr. 96/2016 ka referuar në përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, duke u shprehur se paga referuese është e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të vijoje me analizën e strukturës së pagave të nëpunësve civilë.

67. Neni 34 i ligjit nr. 152/2013 parashikon se paga e nëpunësit civil përbëhet nga: i) paga bazë e kategorisë; ii) shtesa për klasën së cilës i përket pozicioni; iii) shtesa për kushtet e punës. Ndërkohë, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve civilë sipas kategorive është përcaktuar me VKM-në nr. 545/2011 (*VKM-ja e pagave*) së bashku me lidhjet nr. 1-8, pjesë përbërëse të saj, e cila edhe pse fillimisht doli në zbatim të ligjit të mëparshëm për nëpunësin civil, ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*), pasqyroi më tej ndryshimet përkatëse pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 152/2013.

68. Në kohën kur u miratua ligji nr. 96/2016, VKM-ja e pagave, në lidhjen nr. 1, rregullonte strukturën dhe nivelin e pagave edhe për nëpunësit civilë në institucionin e Kryeministrisë. Elementet e pagës sipas këtij akti nënligjor ishin: a) paga e grupit; b) shtesa për vjetërsi; c) shtesa për kualifikim; d) shtesa për pozicion. Struktura e pagave për nëpunësit civilë në institucionet, pjesë e fushës së veprimit të kësaj VKM-je, bazohet mbi klasifikimin në klasa, që më tej ndaheshin në kategori, ndërsa niveli i pagës mujore përbëhej nga dy elemente: i) paga individuale ose paga bazë; ii) shtesa për pozicion. Elementi “pagë individuale” ose “pagë bazë” përfshinte pagën e grupit, të përcaktuar në tre grupe, sipas llojit të diplomave universitare me vlerë fikse për secilin grup, shtesën për vjetërsi, të përcaktuar në masën 2% për çdo vit pune deri në 25 vjet dhe shtesën për kualifikim, të përcaktuar sipas gradës ose titullit shkencor, me pozicione dhe vlera fikse. Ndërsa elementi “shtesë për pozicion” përcaktohej me vlerë fikse për secilën klasë dhe kategori. Klasa e parë ndahet në dy kategori dhe më konkretisht, shtesa për pozicion për kategorinë e parë I-a përcaktohej në vlerën 129,000 lekë, ndërsa për kategorinë e dytë I-b në vlerën 118,000 lekë (shih kolonën 5, lidhja nr. 1).

69. Në VKM-në e pagave, edhe me ndryshimet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, struktura e pagave nuk është përshtatur në kategori dhe më pas në klasa, por vijon të ruajë ndarjen e mëparshme, fillimisht në klasa dhe pastaj në kategori, sipas përcaktimeve të ligjit të mëparshëm të shërbimit civil nr. 8549/1999. Megjithatë, Gjykata në tekstin e këtij vendimi do t'i referohet klasifikimit kategori dhe klasë, ashtu siç përdoren nga ligji, klasifikim që në rastin e VKM-së së pagave përmbledh respektivisht klasën dhe kategorinë.

70. Gjykata vëren se, sipas VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, kategoria e parë përfshinte pozicionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, të cilat, brenda saj, ndaheshin vetëm në dy nivele të mëtejshme, në klasën e parë (I-a), që është niveli më i lartë, dhe në klasën e dytë I-b, që është niveli më i ulët, pra kategoria e parë nuk përmbante nivel (klasë) të tretë (I-c). Ndryshimi midis dy niveleve të kategorisë së parë lidhet me përcaktimin e ndryshëm të vlerës së elementit “shtesë për pozicion”. Kurse paga për pozicionin “drejtor i drejtorisë së përgjithshme” rezulton e kategorizuar në kategorinë e dytë, klasa e parë, e përcaktuar II-a. Nga ana tjetër, në këtë VKM gjenden të klasifikuara në nivelin e pagës I-b disa prej pozicioneve të barasvlershme me drejtorin e drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri. Po kështu, Gjykata vëren se sipas lidhjeve bashkëlidhur VKM-së nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, pozicioni i sekretarit të përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, që është pjesë e shërbimit civil dhe pozicioni i barasvlershëm me drejtorin e drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, është klasifikuar në kategorinë I-b.

71. Paga e secilit pozicion përfshinte edhe elementin e “pagës në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare që, referuar lidhjes nr. 2 të VKM-së së pagave, përfshinte diplomat universitare master i shkencave, master i arteve ose të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, ndërsa vlera e këtij elementi të pagës përcaktohej 14,000 lekë. Në këtë pikë duhet evidentuar se, sipas lidhjes nr. 4 të kësaj VKM-je diploma universitare përbën kriterin minimal të detyrueshëm (kusht) për efekt të pranimit në pozicionin përkatës brenda shërbimit civil, që do të thotë paga e këtij funksioni në shërbimin civil përfshin edhe elementin e “pagës në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare. Për këtë arsye, neni 12, pika 5, shkronja “a”, përmban shprehjen “pagë për funksion”, e cila nuk është e barasvlershme me “shtesën për pozicion”.

72. Në referim të legjislacionit të kohës për nëpunësin civil, Gjykata vlerëson se neni 12 i ligjit nr. 96/2016 ka përcaktuar qartë dhe mjaftueshëm elementet e pagës mujore bruto të magjistratit dhe në veçanti elementin “pagë referuese bazë”. Konkretisht, kjo dispozitë ka përcaktuar se paga referuese bazë është e njëjtë me pagën për funksion të nëpunësve civilë të nivelit më të lartë drejtues, të shprehur në konceptin e kategorisë së parë, klasa e tretë, ku sipas ligjit për nëpunësin civil përfshihet pozicioni i punës “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicioni i barasvlershëm me të”. Fakti se VKM-ja e pagave nuk përmbante klasë të tretë të kategorisë së parë, nuk përbën argument për paqartësi

ose boshllëk të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar. Kjo dispozitë referon në kategorinë e parë, në nivelin/klasën më të ulët të kësaj kategorie dhe njësohej me pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose pozicionet e tjera të barasvlershme me të, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe sekretarët e përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, paga e të cilëve është klasifikuar në kategorinë I-b, për të cilën elementi i shtesës për pozicion, sipas terminologjisë së VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, ishte në vlerën 118,000 lekë.

73. Në këtë kuptim, në lidhje me shprehjen “pagë për funksion” Gjykata vlerëson se nuk qëndron prapësimi i subjekteve të interesuara se ky koncept i ligjit nr. 96/2016, i cili nuk parashikohet shprehimisht në legjislacionin për nëpunësin civil, është i njëjtë me elementin bazë dhe të qëndrueshëm të pagës së nëpunësit civil, konkretisht atij “shtesë për pozicion”, për sa kohë që i tillë është edhe elementi tjetër i pagës për këto pozicione, ai i “pagës në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare. Vlen të përmendet se sipas lidhjes nr. 2 të VKM-së nr. 142/2014, në kërkesat për praninë për pozicionet e punës të klasës I/3, te kërkesat e posaçme për arsimimin përcaktohet “Master shkencor”.

74. Për sa më lart, në kuptim të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, Gjykata vëren se elementi “pagë referuese bazë” i pagës mujore bruto të magjistratit sipas shkronjës “a” të pikës 5 të këtij neni, i referohet pagës për pozicion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, që përfshin “shtesën për pozicion” dhe “pagën në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare për këto funksione.

75. Gjykata thekson se ligjvënësi, në ushtrim të kompetencës së tij, për rregullimin me ligj të pagës së magjistratit ka përcaktuar strukturën dhe nivelin e pagës së kësaj kategorie funksionarësh të lartë shtetërorë. Në kuadër të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, në tekstin e ligjit çdo fjalë mbart një kuptim të caktuar që i shërben qëllimit të vetë ligjit, nga njëra anë, dhe aspektit të parashikueshmërisë së normave juridike, nga ana tjetër. Me fjalë të tjera, argumenti se një dispozitë ligjore duhet të lexohet dhe të zbatohet duke anashkaluar fjalë të caktuara për shkak se ato janë të tepërta ose të parëndësishme, nuk mund të pranohet, sepse bie ndesh me parimet kushtetuese.

76. Nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016, në kohën e miratimit të tij e përmbushte qëllimin për rregullimin e pagës referuese bazë të magjistratit, pasi përcaktonte njësimin e saj me pagën për funksion të punonjësve të shërbimit civil, duke treguar kategorinë (e para (I)), klasën (e treta (c)), si dhe pozicionin konkret të punës (drejtorin e drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo

pozicion tjetër të barasvlershëm me të). Për këtë pagë, në kushtet kur pozicionit të drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri nuk i është caktuar nivel page, referimi është sipas klasifikimit të pozicioneve të barasvlershme me të, pra ai I-b (*shih paragrafin 72 të vendimit*), që në kohën e miratimit të normës ligjore ishte në vlerën 118,000 lekë duke shtuar edhe vlerën 14,000 lekë, që i përket “pagës në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare.

77. Gjykata vëren se në momentin kur filluan të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 96/2016 për pagat dhe përfitimet e tjera të magjistratit, që është data 01.01.2019 sipas dispozitës kalimtare të këtij ligji, kishte hyrë në fuqi VKM-ja nr. 187/2017, në bazë të së cilës u bë përlllogaritja e pagës referuese bazë sipas klasifikimit të këtij akti nënligjor, pra sipas kategorisë së dytë, klasa e parë (II-a), që referuar lidhjes nr. 4 të këtij akti nënligjor përfshin pozicionin “drejtor i drejtorisë së përgjithshme”, për të cilin, sipas lidhjes nr. 1 të këtij akti nënligjor, elementi “shtesë për pozicion” është në vlerën 118,100 lekë, ndërkohë që vlera e këtij elementi për kategorinë e parë, klasa e dytë (I-b) është 129,800 lekë.

78. Gjykata rithekson se referuar mënyrës se si është shprehur *expressis verbis* norma ligjore në momentin e miratimit të saj, kjo dispozitë nuk mbart paqartësi në lidhje me konceptet ku referon, të cilat janë trajtuar dhe zbërthyer në legjislacionin për nëpunësin civil. Ndaj nuk është përmbajtja e normës, por zbatimi i saj jo në linjë me frymën dhe qëllimin e ligjvënësit që ka prodhuar një rezultat të ndryshëm nga ai që ka diktuar vetë norma ligjore, neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016. Megjithatë, Gjykata vlerëson të evidentojë se kjo mënyrë zbatimi e normës është ndikuar nga disa faktorë, siç janë zbatimi i vonuar në kohë i këtyre parashikimeve ligjore, ndryshimet e shpeshta në aktet nënligjore për nëpunësin civil, por edhe faza tranzitore e zbatimit të reformës në drejtësi, që parashikoi mbylljen e disa institucioneve dhe ngritjen e disa institucioneve të reja. Po ashtu, ajo konstaton se pas daljes së raportit të KLSH-së (*shih paragrafin 7 të vendimit*), disa organe kushtetuese administrativisht kanë kryer rillogaritjen e pagave, ndërsa disa organe të tjera kanë vepruar në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të dhëna në përfundim të proceseve gjyqësore të iniciuara individualisht nga magjistratët për këtë qëllim.

79. Duke marrë shkas nga situata e krijuar, ligjvënësi vlerësoi se kishte nevojë për përkufizimin dhe qartësimin e termit “pagë për funksion”, me qëllim shmangien e çdo konfuzioni në interpretimin dhe zbatimin e tij, për rrjedhojë, ndërhyri me ligjin nr. 50/2021 në përmbajtjen e nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, duke përcaktuar se paga referuese bazë për funksionet gjyqësore të prokurorisë është e njëjtë me vlerën e elementit “shtesë për pozicion”, i cili tashmë i përket pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së

përgjithshme ose të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri (*shih paragrafin 9 të vendimit*).

80. Duke krahasuar formulimet ligjore në përmbajtjen tekstuale të tyre, Gjykata konstaton se ato mbartin diferenca të dukshme në referencat e bëra në drejtim të përcaktimit të elementit të pagës bruto mujore të magjistratit, pikërisht të “pagës referuese bazë”. Në formulimin e ri rezulton se është hequr kategorizimi “kategoria e parë, klasa e tretë”, ndërkohë që pozicioni “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion i barasvlershëm me të” është zëvendësuar me frazën “drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo çdo pozicion i barasvlershëm me të në Kryeministri”, zëvendësim i cili ka ulur referencën në rang hierarkik. Sipas lidhjes nr. 4 të VKM-së nr. 187/2017, pozicioni i “drejtorit të drejtorisë së përgjithshme” klasifikohet në kategorinë II-a, ndërsa sipas lidhjes nr. 1 elementi “shtesë për pozicion” për këtë funksion është 118,100 lekë, ndërkohë që për kategorinë I-b, që i korrespondon pozicioneve të barasvlershme, ky element është në vlerën 129,800 lekë.

81. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, pranuan se ndryshimi i shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016 nuk është diktuar nga nevoja për marrjen e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare, por për të qartësuar normën në funksion të sigurisë juridike. Në ndryshim nga sa pretendojnë këto subjekte, në këtë gjykim nuk u konstatua ekzistenca e ndonjë situatë pasigurie juridike.

82. Gjykata vëren se mënyra e zbatimit të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, deri në ndryshimin e saj përmes ligjit nr. 50/2021, ka prodhuar të njëjtin rezultat në vlera financiare me atë sipas formulimit aktual, për shkak se, sikurse është parashtruar, që nga momenti i zbatimit të saj (data 01.01.2019), paga referuese bazë e magjistratit është llogaritur në vlerën 118,100 lekë, që i korrespondon elementit “shtesë për pozicion” të pagës së nëpunësit civil të kategorisë drejtuese, kategoria e dytë, klasa e parë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në ministri. Pavarësisht kësaj mënyre të zbatimit të normës, në kushtet kur ajo diktonte një mënyrë tjetër llogaritjeje të pagës referuese bazë të magjistratit, ndryshimi që i është bërë me ligjin nr. 50/2021 ka sjellë një rezultat, në terma financiarë, më të ulët se sa ai që magjistratët do të përfitonin nga zbatimi korrekt i normës origjinale, sipas përmbajtjes së tekstit të saj dhe vullnetit objektiv të treguar nga ligjvënësi në kohën e miratimit të kësaj norme për herë të parë. Për rrjedhojë, formulimi aktual i normës ligjore objekt i këtij gjykimi kushtetues, edhe pse synimi i pretenduar është qartësimi i përmbajtjes së saj, në fakt ka sjellë ndryshim të dukshëm të kësaj përmbajtjeje, me pasojë

uljen në vlerë të “pagës referuese bazë” e në këtë kuptim uljen e pagës bruto mujore të magjistratit.

83. Gjykata ka theksuar se Kuvendi, në ushtrimin e funksionit kryesor të tij, mbështetet së pari te dispozitat kushtetuese, sepse ligjet që miraton duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 01.03.2021; nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, përcaktimi i politikave shtetërore dhe nismave ligjvënese i përket ekzekutivit dhe legjislativit, por pa cenuar thelbin e shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor (*shih vendimin nr. 11, datë 06.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Në këtë kuptim, pavarësisht hapësirës normuese që ka pushteti ligjvënës, parashikimet ligjore që prekin pagën dhe përfitimet e tjera të magjistratit duhet të jenë në përputhje me garancitë e nenit 138 të Kushtetutës, i cili lejon uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera me efekt të përgjithshëm vetëm për interes publik, kuptimi i të cilit materializohet shprehimisht në këtë dispozitë. Në këtë drejtim, siç është theksuar edhe më sipër, në ndryshim nga sa pretendojnë subjektet e interesuara, nuk u konstatua që norma të mbartte paqartësi që sillte nevojën e ndërhyrjes për sqarimin e përmbajtjes së saj, ndërkohë që Gjykata vlerëson të theksojë se është akti nënligjor që duhet të ndjekë konceptet dhe terminologjinë e ligjit dhe jo anasjelltas.

85. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ligjvënësi ka vepruar në kushtet e ndalimit të parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës, ndaj përmbajtja e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016 duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me këtë normë kushtetuese.

B.1.2. Për cenimin e pensionit suplementar të magjistratit

86. Sipas kërkuesit, garancitë kushtetuese cenohen edhe nga përmbajtja e ndryshuar e nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996. Për magjistratët, në ndryshim nga sa parashikohet për subjektet e tjera të ligjit, paga referuese është e ndarë në tri periudha dhe është vendosur si tavan paga e Presidentit, edhe pse atyre u mbahen kontribute mbi një pagë bruto më të lartë. Këto parashikime janë negative edhe në raport me ato të nenit 21 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë mënyrë cenohen pritshmëritë e ligjshme të magjistratëve që trajtimi i tyre, sipas kësaj dispozite, të ishte i njëjtë me subjektet e tjera dhe të mos pësonte ndryshime të disfavorshme.

87. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, ndryshimet kanë ndodhur në skemën e pensionit suplementar dhe jo në atë bazë të pensioneve, e cila ka mbetur e pandryshuar. Ligji synon të përcaktojë një raport sa më të drejtë të përfitimit me kontributet, pasi skema e

pensionit suplementar është një skemë që financohet kryesisht nga fondet publike buxhetore, ndaj një ndërhyrje e tillë është e justifikuar për ruajtjen e qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit. Në rastin konkret nuk preket asnjë e drejtë e fituar dhe sasia e kontributeve që derdh një nëpunës nuk është shkak për antikushtetutshmërinë e një ligji.

88. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, për të pasur një raport sa më të drejtë të përfitimit me kontributet, paga referuese është kufizuar me atë të Presidentit, si funksioni më i lartë i përcaktuar me VKM-në nr. 548/2016. Skema e pensioneve suplementare subvencionohet në masën mbi 75% nga buxheti i shtetit dhe ajo mund të kufizohet në përputhje me politikën shtetërore. Ndarja e periudhave para dhe pas datës 01.01.2019 është bërë pasi në këtë datë kanë hyrë në fuqi ndryshimet e sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magjistratët, kurse për shkronjën “c” është parashikuar paga e ponderuar bazuar në pagat përpara dhe pas reformës në drejtësi. Kjo ndarje është e lidhur me kontributet e derdhura gjatë secilës periudhë.

89. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se garancitë e tjera që parashikon neni 138 i Kushtetutës janë pjesë integrale të statusit të gjyqtarit dhe, si të tilla, i shërbejnë pavarësisë së gjyqësorit (*shih vendimin nr. 23, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” në nenin 138 të Kushtetutës është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutëbërësi, jo pa qëllim, e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se pensionet dhe përfitimet e tjera duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimet nr. 40, datë 07.07.2014; nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

90. Sipas pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 96/2016, përfitimet e tjera financiare të magjistratit përfshijnë: a) kompensim për transferimin e përkohshëm ose skemën e delegimit; b) shpërblim për aftësi; c) pension shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjisllacionit për pensionet shtetërore suplementare; ç) çdo përfitim tjetër, duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit, të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pensioni shtetëror suplementar është një nga përfitimet e tjera të magjistratit që përfshihet në fushën e mbrojtjes së nenit 138 të Kushtetutës. Gjykata, rithekson, gjithashtu, se për pensionet suplementare, ashtu si dhe për pagat, standardi i paprekshmërisë së tyre është ngritur në nivel kushtetues, duke qenë kjo një çështje e rregulluar drejtpërdrejt nga neni 138 i Kushtetutës, i cili ka

parashikuar në mënyrë shteruese rastet kur është e lejueshme të ndërhyhet në to (*shih paragrafin 53 të vendimit*).

91. Gjykata vlerëson të përmendë fillimisht interesin publik në lidhje me mirëfunksionimin dhe qëndrueshmërinë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke respektuar edhe parimin e mundësive dhe të drejtave të barabarta për kontribuesit, si dhe parimin e drejtësisë sociale, nga i cili duhet të orientohet ligjvënësi për të siguruar rishpërndarjen e mjeteve financiare midis grupeve të ndryshme të popullsisë (*shih vendimin nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

92. Gjykata vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, pika 7 e nenit 1 të ligjit nr. 8097/1996 kishte këtë përmbajtje: *“Me termin “pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë. Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe pagesës kalimtare.”*.

93. Me nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166/2020, ndërsa paragrafi i parë mbeti i pandryshuar, paragrafi i dytë u ndryshua si vijon: *“Për funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, me termin “pagë referuese” kuptohet: a) për personat, të cilët kanë vite shërbimi deri më 31.12.2018, pavarësisht datës së lindjes të së drejtës për përfitim, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion apo detyrë, sipas legjislacionit në fuqi, deri në datën 31.12.2018; b) për personat, të cilët kanë vite shërbimi pas datës 1.1.2019, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës; c) për personat, të cilët kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018, paga referuese për periudhën e shërbimit është paga mesatare mujore referuese që llogaritet si raport i shumës së pagave referuese të të gjitha funksioneve e detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, me shumën e muajve që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet e detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe e pagesës kalimtare.”*.

94. Gjykata vlerëson të theksojë paraprakisht se kjo dispozitë zbatohet edhe ndaj disa funksionarëve të tjerë, paga e të cilëve referohet te ligji nr. 96/2016, ndërkohë që objekt i këtij gjykimi kushtetues është kontrolli i normës ligjore për sa ajo prek të drejtën e magistratëve për pension shtetëror suplementar.

95. Ligji nr. 8097/1996 ka përcaktuar jo vetëm kriteret për të përfituar pensionin suplementar, por edhe nivelin maksimal të këtij pensioni sipas grupeve, si dhe nivelin maksimal të përfitimit të këtij pensioni së bashku me atë të përfituar sipas ligjit nr. 7703/199. Në lidhje me pagën referuese bazë, ligji nënkupton pagën e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion ose detyrë. Në dallim nga ky parashikim, i cili kishte filluar të zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjitha subjektet përfituese, përfshirë edhe funksionet e referuara në ligjin nr. 96/2016, ligjvënësi ka miratuar rregullimet e kundërshtuara, të cilat ndryshojnë pagën referuese.

96. Kështu, magjistratët, subjekte përfitues, janë ndarë në tre kategori: i) ata që kanë vite shërbimi deri në datën 31.12.2018; ii) ata që kanë vite shërbimi pas datës 01.01.2019; iii) ata që kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018. Më tej, për secilën nga këto kategori ligji ka përcaktuar një kuptim dhe zbatim të ndryshëm të pagës referuese, për rrjedhojë një llogaritje të ndryshme të masës së përfitimit. Për kategorinë (i), pavarësisht datës së lindjes të së drejtës për përfitim, me “pagë referuese” kuptohet paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion ose detyrë, sipas legjislacionit në fuqi, deri në datën 31.12.2018. Pra, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, që ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016 dhe që vijon të jetë ende në fuqi, sipas të cilit me “pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion ose detyrë, për këtë kategori magjistratësh “paga referuese” kufizohet me pagën deri në datën 31.12.2018. Ndërsa e drejta për përfitim të pensionit suplementar lind pas kësaj date, “paga referuese” e kufizuar me pagën e asaj periudhe rezulton të jetë më e ulët.

97. Për kategorinë (ii), me “pagë referuese” kuptohet paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit. Edhe në këtë rast, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, për këtë kategori magjistratësh “paga referuese” kufizohet me pagën e Presidentit, pagë kjo që rezulton të jetë më e ulët.

98. Për kategorinë (iii), pagë referuese kuptohet paga mesatare mujore referuese që llogaritet si raport i shumës së pagave referuese të të gjitha funksioneve e detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, me shumën e muajve që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet e detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit. Pra edhe për këtë kategori, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, “paga referuese” jo vetëm nuk llogaritet sipas pagës së muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por ajo kufizohet me pagën e Presidentit, çka bën që “paga referuese” për

këtë kategori magistratësh të rezultojë më e ulët. Përcaktimi i ndryshëm i “pagës referuese” për magistratët, duke e kufizuar me pagën e muajit të fundit deri në datën 31.12.2018, sipas shkronjës “a”, duke e kufizuar me pagën e Presidentit, sipas shkronjës “b”, si dhe duke e kufizuar me pagën mesatare mujore referuese dhe me pagën e Presidentit, sipas shkronjës “c”, nuk përputhet me konceptin bazë të “pagës referuese”, atë të pagës së muajit të fundit për detyrën/funksionin.

99. Nga ana tjetër, në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 7 të nenit 1 është vendosur një tavan përfitimi që referon te paga e Presidentit, kufizim ky që shkon përtej kufijve dhe vlerave maksimale të përfitimit që ka vendosur vetë ligji për të gjitha subjektet përfituese ndaj të cilave zbatohet. Gjykata vëren se në kushtet kur paga e magistratit është rritur dukshëm krahasuar me kategoritë e tjera të pagave të funksionarëve publikë, edhe masa e kontributeve të këtyre subjekteve është në raport me këtë nivel të ri page. Për rrjedhojë, vendosja e një mase përfitimi tavan, bazuar në një pagë që nuk përputhet me nivelin e pagës së magistratit, automatikisht prek masën e pensionit suplementar, duke e ulur atë.

100. Dispozitat e kundërshtuara diferencojnë qartazi jo vetëm kategoritë e përfshira në pikën 7 të nenit 1 nga subjektet e tjera përfituese të këtij ligji, por edhe brenda kësaj kategorie diferencojnë magistratët sipas periudhës së ushtrimit të funksionit të tyre, para dhe pas datës 01.01.2019, diferencim ky që nga subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, nuk u justifikua se është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 138 të Kushtetutës. Gjykata thekson se ligji nr. 8097/1996 ka filluar të zbatohet për magistratët menjëherë me fillimin e zbatimit të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 96/2016, duke u përfshirë këto përfitime në konceptin kushtetues “përfitime të tjera”, për rrjedhojë në fushën e mbrojtjes së nenit 138 të Kushtetutës.

101. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe parashikimet e nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8097/1996 nuk respektojnë parashikimet e nenit 138 të Kushtetutës.

102. Në përfundim, Gjykata vlerëson se për sa kohë që dispozitat e kundërshtuara kanë ndryshuar me efekt negativ pagën dhe përfitimet e tjera që burojnë nga statusi i magistratit, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ato janë të papajtueshme me nenin 138 të Kushtetutës, për rrjedhojë duhet të shfuqizohen.

103. Në lidhje me efektet e këtij vendimi, Gjykata, duke theksuar rëndësinë e garancive dhe të parimeve kushtetuese me të cilat bien ndesh dispozitat e kundërshtuara, si dhe duke vënë në balancë interesat e mbrojtura kushtetutshmërisht, vlerëson se, në përputhje me pikën

2 të nenit 132 të Kushtetutës dhe nenin 76, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000, ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

104. Gjykata vlerëson të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t'i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formule tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të tij. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor ai duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveçse kur verifikohet përjashtimi i nenit 138, shkronja "a", të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja "d", 51/a, pika 1, shkronja "b" dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Shfuqizimin e nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat "a", "b" dhe "c" të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166/2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.11.2022

Shpallur më 30.12.2022